

Vendim nr. 50, datë 21.04.2026

(V- 50/26)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Asim Vokshi, Sonila Bejtja, anëtarë, me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 21.04.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 12 (D) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **DRITAN GJELI**, përfaqësuar nga avokati Agron Aliaj, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:

ESMA KRASHNICA (KRASNIQI), përfaqësuar nga avokatja Vojsava Agovi, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1571 (186), datë 23.05.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarit Dritan Gjeli (*kërkuari*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, propësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Esmë Krashnicës (Krasniqi), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari është trashëgimtar ligjor i babait të tij të ndjerë Sh.Gj. Ky i fundit, në vitin 1992 ka blerë nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit, dega Fier, një sipërfaqe trualli prej 15 m² dhe me një leje ndërtimi të vitit 1991 në këtë sipërfaqe ka ndërtuar një lokal. Në vitin 1999 trashëgimlënësi i kërkuarit i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, ku ka bërë njohjen si pronar me anë të vendimit nr. 480, datë 08.04.1999, duke u regjistruar në regjistrin e pronave me notën e transkriptimit nr. 446, datë 26.04.1999.

2. Prona e trashëgimlënësit të kërkuarit është brenda sipërfaqes së fituar në bazë të vendimit nr. 152, datë 21.09.1995 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në Bashkinë e Fierit (*KKKP-ja, Fier*) nga i ndjeri M.A., të cilit i është njohur pronësia për një sipërfaqe trualli prej 400 m², nga të cilat, trashëgimtarët e këtij të fundit kanë regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (*ZVRPP*) Fier 385 m². Gjatë azhurnimit në terren, për qëllim të këtij regjistrimi, ka rezultuar se një pjesë e sipërfaqes ishte e zënë dhe e regjistruar në emër të trashëgimlënësit të kërkuarit. Në këto kushte, një nga trashëgimtarët e ish-pronarit M.A., subjekti i interesuar, Esmë Krashnica (Krasniqi), i është drejtuar gjykatës me kërkesë për lirimin dhe dorëzimin e truallit sipas nenit 296 të Kodit Civil.

3. Gjykata e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 1574, datë 08.10.2008 (*vendimi nr. 1574/2008*), ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e trashëgimlënësit të kërkuarit t'i lirojë dhe t'i dorëzojë të lirë nga çdo barrë paditëse sipërfaqen e truallit objekt konflikti gjyqësor. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim trashëgimlënësi i kërkuarit. Ky vendim është prishur nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 7, datë 13.01.2010, duke e dërguar çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-2530 (512), datë 15.11.2012, e ka kthyer atë sërish për rigjykim në gjykatën e apelit.

4. Gjykata e Apelit Vlorë, në rigjykim, me vendimin nr. 75 (60-2013-989), datë 16.10.2013, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1574/2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe rrëzimin e padisë së subjektit të interesuar. Kjo e fundit ka paraqitur rekurs ndaj këtij vendimi.

5. Referuar vendimit për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. 1713 rep., nr. 819 kol., datë 24.12.2021 të noteres publike, në datën 21.11.2021 ka ndërruar jetë shtetasi Sh.Gj., palë e paditur në procesin gjyqësor. Ndër trashëgimtarët ligjorë të tij është edhe kërkuesi, i biri.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1571 (186), datë 23.05.2022, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 75 (60-2013-989), datë 16.10.2013 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 1574/2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

7. Me kërkesë të subjektit të interesuar, palë kreditore, është lëshuar urdhri i ekzekutimit, vendimi nr. 62-2024-6955 (784), datë 27.12.2024 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Po me kërkesë të subjektit të interesuar, një përmbarues gjyqësor privat i ka dërguar trashëgimlënësit të kërkuesit, palë debitore, lajmërimin për ekzekutimin vullnetar të titullit ekzekutiv, vendimin nr. 1574/2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier. Pasi është njoftuar nga kërkuesi se ai kishte ndërruar jetë, përmbaruesi ka vijuar me kalimin procedural tek trashëgimtarët e tij ligjorë, përfshirë kërkuesin.

8. Nga ana tjetër, në vitin 2015, trashëgimlënësi i kërkuesit dhe shtetasi F.Z. kanë vënë në lëvizje një proces tjetër gjyqësor të lidhur me të njëjtën pasuri, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të KKKP-së, Fier, që ka njohur pronar të ndjerin M.A., si dhe detyrimin e palës së paditur, trashëgimtarët e ish-pronarit M.A., për t'i njohur pronarë mbi sipërfaqen objekt konflikti dhe çregjistrimin e pasurisë për pjesën e mbivendosur.

9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62-2017-5862 (1635), datë 30.11.2017, ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadsisë dhe anulimin e pjesshëm të vendimit të KKKP-së, Fier, vetëm për sipërfaqen që u takon paditësve dhe detyrimin e palës së paditur për t'i njohur pronarë, si dhe çregjistrimin e kësaj sipërfaqeje toke nga ana e ZVRPP-së, Fier. Ky vendim është lënë në fuqi nga ana e Gjykatës së Apelit Vlorë me vendimin nr. 4347, datë 19.06.2019.

10. Në datën 16.06.2025 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), duke kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë për lënien në fuqi të vendimit nr. 1574/2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në të cilin përcaktohej detyrimi i trashëgimlënësit të kërkuesit për të liruar dhe për të dorëzuar sipërfaqen e truallit objekt konflikti gjyqësor. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 30.07.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve dhe thirrjen e subjektit të interesuar, i cili është njoftuar rregullisht. Në datën 08.09.2025 subjekti i interesuar ka paraqitur parashtrimet me shkrim, duke kërkuar rrëzimin e kërkesës, ndërsa në datën

08.04.2026 ka paraqitur një shtesë parashtrimesh, duke bashkëlidhur kopje të procesverbalit të datës 01.04.2026 të një përmbartuesi gjyqësor privat për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë nr. 1574/2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe kopje të procesverbalit të të njëjtit përmbartues për kronologjinë e ekzekutimit të vendimit.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

11.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, në aspektet e mëposhtme:

11.1.1. *E drejta e aksesit e lidhur me standardin e arsytimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë në vendimin e saj nuk ka arsyetuar për disa prej prapësimeve të palës së paditur, duke i lënë ato pa përgjigje, duke përfshirë: i) përse trashëgimlënësi i kërkuesit është konsideruar posedues i paligjshëm, në një kohë që ka paraqitur prova se ishte posedues i ligjshëm i truallit me sipërfaqe 15 m², se ishte pajisur me autorizim për blerjen e truallit nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit Fier, me leje ndërtimi të lëshuar nga ish-Komiteti Ekzekutiv i qarkut Fier dhe se ishte njohur pronar në bazë të vendimit nr. 480, datë 08.04.1999 të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier; ii) si ishte zhveshur në mënyrë të paligjshme subjekti i interesuar nga pronësia, kur ndërtimi nga trashëgimlënësi i kërkuesit është realizuar me leje ndërtimi të lëshuar nga institucionet përgjegjëse të asaj kohe në vitin 1991, ndërsa trashëgimlënësit të subjektit të interesuar i është kthyer prona në vitin 1995, për më tepër që nuk është mbajtur një procesverbal për dorëzimin efektiv të këtij trualli; iii) si do të lirohet trualli ndërkohë që mbi të është ndërtuar një lokal me leje, i cili është i përhershëm dhe i ligjshëm. Po kështu, nga ana e Gjykatës së Lartë nuk është arsyetuar se përse janë konfirmuar faktet e pranuar nga gjykata e shkallës së parë në raport me ato të gjykatës së apelit, duke mos evidentuar asnjë gabim ligjor në çmuarjen e provave nga kjo e fundit dhe përse nuk ka mbajtur një qëndrim për provat e reja të marra gjatë procesit në gjykatën e apelit, dhe as përse është revokuar vendimi i vitit 2014 për kalimin në seancë gjyqësore dhe në vitin 2022 është vendosur që çështja të gjykohet në dhomën e këshillimit. Ajo gjykatë nuk ka arsyetuar në mënyrë shteruese as për zbatimin dhe interpretimin e ligjit material, për situatën sesi mund të kthehet një send i pakthyesëm kur trualli posedohet në mënyrë të ligjshme. Të gjitha këto pretendime të lëna pa përgjigje kanë cenuar standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

11.1.2. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë të njëjtat fakte të çështjes i ka vlerësuar ndryshe nga gjykatat e faktit. Ai kolegji ka vlerësuar fakte që nuk janë vlerësuar nga gjykata e apelit, duke pranuar si të sakta faktet e pranuar *apriori* nga gjykata e shkallës së parë. Kolegji Civil gjithashtu ka injoruar situatën që gjykata e apelit e ka gjykuar këtë çështje në fakt dhe ka marrë një sërë provash të reja, të cilat nuk ishin marrë dhe nënshtruar hetimit gjyqësor nga shkalla e parë. Pikërisht nxjerrja e konkluzioneve të ndryshme nga provat në raport me gjykimin në apel nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë.

11.1.3. *E drejta për t'u njoftuar e lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, si dhe me parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, pasi Kolegji Civil megjithëse është vënë në dijeni nga shërbimi postar në aktin e njoftimit të zhvillimit të gjykimit në dhomën e këshillimit që trashëgimlënësi i kërkuarit kishte ndërruar jetë, nuk ka marrë masat për kryerjen e veprimit të detyrueshëm të kalimit procedural tek trashëgimtarët e tij, por ka zhvilluar gjykimin në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve, duke iu mohuar trashëgimtarëve të të ndjerit Sh.Gj. të drejtën për t'u njoftuar, për të paraqitur pretendime dhe fakte të reja, siç është vendimi i formës së prerë i procesit gjyqësor paralel i nisur nga trashëgimlënësi i kërkuarit për shfuqizimin e vendimit të KKKP-së, Fier dhe detyrimin për ta njohur atë pronar të sipërfaqes së mbivendosur.

11.2. *E drejta e pronës*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë, në shkelje të parimeve kushtetuese të procesit të rregullt ligjor, e ka zhveshur atë nga e kjo e drejtë.

12. ***Subjekti i interesuar, Esmë Krashnica (Krasniqi)***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se pretendimet e kërkuarit nuk janë ngritur në nivel kushtetues, pasi nuk përmbajnë shkaqe të asaj natyre që të cenojnë liritë dhe të drejtat themelore të tij, konkretisht:

12.1. Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit* nuk mund të merren në shqyrtim, pasi lidhen me faktet, rrethanat, provat e çështjes, pra me zgjidhjen e çështjes në themel, që nuk është pjesë e juridiksionit kushtetues.

12.2. Pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj nuk qëndron, pasi shqyrtimi i çështjes ka filluar në vitin 2008, duke kaluar dy herë ciklin e shqyrtimit gjyqësor në të tria shkallët e gjykimit, ku janë marrë dhe janë administruar dy herë të gjitha provat shkresore të mundshme dhe të disponueshme. Gjykata e Lartë është gjykatë ligji dhe vlerëson mënyrën e

zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Në rastin konkret, ajo gjykatë ka vepruar brenda të gjithë kornizës ligjore në fuqi, duke marrë në analizë dhe realizuar një interpretim të drejtë të ligjit material për zgjidhjen e çështjes. Pretendimet e kërkuarit që lidhen me faktet, rrethanat dhe provat e administruara në gjykim, janë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme dhe jo të kësaj Gjykate, e cila nuk është shkallë e katërt gjykimi. Si të tilla, këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim nga Gjykata.

12.3. Pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, si dhe me parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit është i pabazuar, pasi shkresa nr. 11115-00080-00-2014 prot., datë 25.04.2022 "Njoftim për zhvillim gjykimi në dhomë këshillimi", që Gjykata e Lartë i ka dërguar trashëgimlënësit të kërkuarit, ka të vendosura mbi të dy shënime kontradiktore, "Larguar" dhe "Ka ndërruar jetë", që të bënë të mendosh se ky shënim i fundit nuk është bërë nga nëpunësi i postës, për më tepër që shkrimet janë të ndryshme. Shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë bëhet si rregull mbi bazë të dokumenteve. Referuar nenit 482 të Kodit të Procedurës Civile (KPC) njoftimi individual i palës ndërgjyqëse ose i përfaqësuesit të saj ligjor nuk është detyrues në kuptim të ligjit në lidhje me vlefshmërinë e njoftimit. Gjykata e Lartë ka konkluduar se zgjidhja e çështjes nuk diktohet ose nuk gjendet në kushtet e zbatimit të nenit 482/a të KPC-së, për kalimin për shqyrtim të saj në seancën gjyqësore me praninë e palëve. Debati gjyqësor është zhvilluar rregullisht në gjykatat më të ulëta, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

13. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së

kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga aktet e vëna në dispozicion, Gjykata vëren se trashëgimlënësi i kërkuesit ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe ndonëse gjykatat e zakonshme nuk kanë bërë kalimin procedural tek trashëgimtarët pasi ai ka ndërruar jetë, kërkuesi, duke qenë trashëgimtar i tij, ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen objekt gjykimi, për rrjedhojë legjitimohet *ratione personae*.

15. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, që pretendohet se janë cenuar. Në rastin në shqyrtim, kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë që ka përmbyllur procesin gjyqësor ku trashëgimlënësi i tij ka qenë palë e paditur. Në këtë situatë, ai nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimit të kundërshtuar, përveç ankimit kushtetues individual, ndaj konsiderohet i përmbushur kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

16. Për legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në këtë drejtim, duke iu referuar jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), Gjykata ka pohuar se, në radhë të parë, i takon Gjykatës së Lartë të sigurojë që në dosjen e çështjes së saj të ketë prova për datën e dorëzimit të vendimit palëve (*shih vendimin nr. 69, datë 06.11.2025 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është i datës 23.05.2022, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 16.06.2025, pra pothuajse pas 3 vjetësh. Kërkuesi ka pretenduar se nuk i është njoftuar vendimi i Gjykatës së Lartë, ndërsa i ati i tij që ka qenë palë në proces dhe avokati që e ka përfaqësuar atë në gjykatat e faktit, kishin ndërruar jetë mbi një vit përpara se çështja të shqyrtohej në dhomën e këshillimit. Referuar dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, Gjykata vëren se njoftimi për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit nr. 11115-00080-00-2014 prot., datë 25.04.2022 të Gjykatës së Lartë, drejtuar të atit të kërkuesit, është kthyer mbrapsht me shënimin “Personi ka ndërruar jetë (ka vdekur)”.

18. Për sa më lart, duke mbajtur në konsideratë jurisprudencën e GJEDNJ-së lidhur me detyrimin e Gjykatës së Lartë për njoftimin e vendimeve të saj, faktin se barra e provës në këtë drejtim nuk mund të rëndojë mbi kërkuesin në rrethanat e rastit konkret, pasi do të krijonte një barrë të tepruar ndaj tij, si dhe faktin se ai e ka paraqitur ankimin kushtetues individual një muaj pas marrjes dijeni për vendimin e Gjykatës së Lartë, Gjykata çmon se ai legjitimohet *ratione temporis*.

19. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregull ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në disa aspekte (e drejta e aksesit e lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, ajo për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, e drejta për t'u njoftuar e lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar, si dhe me parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit), për rrjedhojë dhe të drejtën për pronë private.

20. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së pronës private, Gjykata mban në konsideratë se argumentet e dhëna nga kërkuesi lidhen me procesin gjyqësor të kundërshtuar prej tij dhe, për rrjedhojë, çështja do të analizohet në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor.

21. Pretendimet e tjera të kërkuesit bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues ndaj do të trajtohen në vijim për bazueshmërinë e tyre.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar, si dhe me parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit

22. Kërkuesi ka pretenduar se ndonëse Gjykata e Lartë është vënë në dijeni që trashëgimlënësi i tij, palë e paditur në proces, kishte ndërruar jetë, nuk ka marrë masat për kalimin procedural, por ka zhvilluar gjykimin në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve. Për rrjedhojë, kërkuesi, trashëgimtar ligjor i tij, nuk ka marrë dijeni, duke iu mohuar e drejta për të paraqitur fakte dhe argumente, siç ishte vendimi i formës së prerë i procesit gjyqësor paralel për shfuqizimin e vendimit të KKKP-së, Fier dhe detyrimin për ta njohur atë pronar të sipërfaqes së mbivendosur.

23. Subjekti i interesuar, Esmë Krashnica (Krasniqi), ka prapësuar se për shkresën e paraqitur nga kërkuesi për njoftimin për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit, ka dy shënime kontradiktore, çka të bën të mendosh se njëri prej tyre nuk është bërë nga nëpunësi i postës. Shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë bëhet, si rregull, mbi bazë të dokumenteve dhe se, referuar nenit 482 të KPC-së, njoftimi individual i palës ndërgjyqëse nuk është i detyrueshëm. Sipas saj, Gjykata e Lartë ka konkluduar se zgjidhja e çështjes nuk diktohet ose nuk gjendet në kushtet e zbatimit të nenit 482/a të KPC-së, për kalimin për shqyrtim të saj në

seancë gjyqësore me praninë e palëve. Debati gjyqësor është zhvilluar rregullisht në gjykatat më të ulëta, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit.

24. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon pashmangshmërisht në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti në të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 37, datë 30.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. E drejta e palës për t'u njoftuar për argumentet e faktet e parashtruara në ankimin e palës tjetër është pjesë e së drejtës së individit për një proces të rregullt, nëpërmjet së cilës atij i krijohet mundësia të përgatisë mbrojtjen e vet e të parashtojë argumentet ndaj pretendimeve të palës tjetër (*shih vendimet nr. 18, datë 04.04.2023; nr. 5, datë 26.01.2007; nr.15, datë 13.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i takon procesit në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike ose mbi bazë të dokumenteve, ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe të parimit të barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimet nr. 14, datë 21.03.2023; nr. 28, datë 01.11.2022; nr. 21, datë 04.04.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykata vëren se kërkuesi, në thelb, pretendon se nga ana e Gjykatës së Lartë nuk është kryer kalimi procedural tek trashëgimtarët e të paditurit Sh.Gj., duke i mohuar në këtë mënyrë atyre të drejtën për të paraqitur prapësime/argumente që mund të ndryshonin fatin e çështjes. Në këtë kuptim, Gjykata do të verifikojë nëse në rastin konkret është garantuar e drejta për t'u njoftuar për procesin, me pasojë cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur dhe parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit.

27. Referuar materialeve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, rezulton se administrata e Gjykatës së Lartë ka dërguar në rrugë postare shkresën nr. 11115-00080-00-2014 prot., datë 25.04.2022, me objekt: "Njoftim për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit" drejtuar shtetasit Sh.Gj. Kjo shkresë nuk ishte arritur të dorëzohej për shkak se i padituri kishte ndërruar jetë në vitin 2021 dhe rezulton se për këtë shkresë të

padorëzuar ishte lënë shënimi “*Personi ka ndërruar jetë (ka vdekur)*”, fakt ky i konfirmuar edhe nga dëshmia e trashëgimisë ligjore nr. 1713 rep., nr. 819 kol., datë 24.12.2021 të noteres publike, si dhe nga certifikata e vdekjes, të administruara në këtë gjykim kushtetues. Më pas, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim, në dhomën e këshillimit, shkaqet e rekursit të subjektit të interesuar Esma Krashnicës (Krasniqi), duke i gjetur të drejta ato dhe duke vendosur rrjedhimisht prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Me kërkesë të subjektit të interesuar, palë kreditore, është lëshuar urdhri i ekzekutimit dhe, po me kërkesë të saj, përmbaruesi gjyqësor privat i ka dërguar palës debitorë lajmërimin për ekzekutimin vullnetar të titullit ekzekutiv. Pasi është njoftuar nga kërkuesi se ai ka ndërruar jetë, përmbaruesi ka vijuar me kalimin procedural nga Sh.Gj.-ja tek trashëgimtarët e tij.

28. Për sa më sipër, Gjykata e Lartë ka dërguar në adresën e të atit të kërkuesit, palë e paditur në proces, njoftimin për zhvillimin e gjykimit në dhomën e këshillimit, megjithatë ai njoftim nuk është realizuar, duke mos u përmbushur nga ajo gjykatë detyrimi për të njoftuar palët në proces për zhvillimin e gjykimit, në kushtet që kërkuesi dhe bashkëtrashëgimtarët e tij nuk kanë marrë dijeni për procesin që ishte duke u zhvilluar në Gjykatën e Lartë, me palë të paditur trashëgimlënësin e tyre. Vendimi i kundërshtuar i asaj gjykate nuk është një vendim mospranimi i marrë në ushtrim e sipër të veprimtarisë seleksionuese të kësaj të fundit, por nëpërmjet atij janë vlerësuar në themel shkaqet e rekursit të subjektit të interesuar, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, në favor të kësaj të fundit, dhe në disfavor të kërkuesit, që detyronte trashëgimlënësin e tij që t’i lironte dhe t’i dorëzonte të lirë nga çdo barrë sipërfaqen e truallit objekt konflikti gjyqësor subjektit të interesuar. Pavarësisht kësaj, me gjithë dijeninë për faktin se pala e paditur kishte ndërruar jetë, Gjykata e Lartë nuk ka proceduar me kalimin procedural tek trashëgimtarët e palës që ka ndërruar jetë, duke i vënë kështu në pamundësi objektive për të marrë dijeni për procesin gjyqësor në Gjykatën e Lartë, por edhe për të ushtruar të drejtat që u garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në këtë fazë të procesit, pra për të paraqitur përmes prapësimeve argumente në mbrojtje të interesave të tyre ligjorë e kushtetues. Edhe pse Gjykata e Lartë ka detyrimin të verifikojë, në këndvështrim të garantimit të së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të barazisë së armëve, nëse administrata gjyqësore ka marrë masat për të njoftuar palët ndërgjyqëse për procesin, ajo nuk është kujdesur për kryerjen e këtij vlerësimi.

29. Duke mbajtur në konsideratë, nga njëra anë, se kërkuesi ka argumentuar sesi kjo shkelje ka pasur ndikim vendimtar në ecurinë e procesit dhe interesat e tij, pra ekzistenca e një procesi gjyqësor paralel, i cili kundërshtonte vetë titullin e pronësisë që ishte në themel të gjykimit objekt shqyrtimi dhe, nga ana tjetër, se Gjykata e Lartë ka zhvilluar një proces themeli,

duke prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, Gjykata konkludon se shkelja është thelbësore. Mosrealizimi i kalimit procedural në këtë rast ka ndikuar drejtpërdrejt në të drejtën për t'u dëgjuar, parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, por edhe në sigurinë juridike, duke marrë në konsideratë se në procesin paralel gjykatat i kanë të dhënë të drejtë trashëgimlënësit të kërkuarit. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se shkeljet e konstatuara kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, duke e bërë atë proces të parregullt në kuptimin kushtetues, ndaj ky pretendim i kërkuarit është i bazuar.

30. Për sa është arsyetuar më sipër, Gjykata vlerëson se çështja duhet të merret sërish në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, e cila duhet të kujdeset të njoftojë edhe trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit Sh.Gj. për shqyrtimin e rekursit të subjektit të interesuar, duke garantuar një proces të rregullt gjyqësor në respektim të së drejtës për t'u njoftuar dhe parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit.

31. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se në zbatim të parimit të *subsidiaritetit* kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është funksion edhe i Gjykatës së Lartë, çmon të mos ndalet në analizimin e pretendimeve të tjera të kërkuarit që kanë të bëjnë me të drejtën e aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, dhe të drejtën për pronë private, për sa kohë që çështja do të merret sërish në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, dhe kjo e fundit duhet t'u japë përgjigje të arsyetuara këtyre pretendimeve.

32. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar, si dhe me parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1571 (186), datë 23.05.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 21.04.2026

Shpallur më 18.06.2026